



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës

Nr. 01/ 633.

Datë; 26/04/2022

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja a, b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 26.04. 2022 mori këtë;

V E N D I M

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 44,880.50 €.

I I. Mjetet lejohen në emër të miratimit të kërkesës nr.11/664, dt.19.04.2022, të drejtorisë për arsim dhe edukim, për furnizimin me rekuizita sportive për nevojat e shkollave fillore dhe të mesme të KK-Malishevës, për gjysmë vjetorin e dytë të vitit shkollor 2021/2022 dhe për vitin shkollor 2022/2023.

I I I. Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet, drejtoria për arsim dhe edukim, përmes shërbimit të prokurimit publik.

I V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Komunës
Ekrem Kastrati



Vendimi ju dorëzohet:

1. Drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet,
2. Drejtorisë për arsim dhe edukim,
3. Shërbimit të prokurimit,
4. Arkivit të komunës.



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E MALISHEVËS

Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë: 08/04/2022

PRANUAR NË:

ACCEPTED ON:

PRILJENO:

Nr.No.Br.

15-04-2022

01/581

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja a, b, c dhe f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Ligjin, nr.06/L-081, dt.30. Maj 2019, për qasjen në dokumentet publike, neni 1, 2 neni 4 neni 5, 6, 7 dhe neni 10, dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 08.04.2022 mori këtë;

V E N D I M

I. z.Izet Shala, i sistemuar me punë dhe detyra të punës, Udhëheqës i Njesisë për Informim Publik, i caktohet detyra e zyrtarit përgjegjës për qasje në dokumentet publike, në administratën e komunës së Malishevës.

I I. I cekuri duhet që të kryej të gjitha përgjegjësitë në pajtim me, dispozitat ligjore të përcaktuara sipas Ligjit nr.06/L-081, dt.30.05.2019, përkatësisht neni 13.

I I I. Ky vendim hyn në fuqi me datë 08.04.2022, i njëjti do të jetë në fuqi, deri sa ky organ vendos ndryshe në lidhje me këtë çështje.

Kryetari i Komunës
Ekrem Kastrati



Vendimi ju dorëzohet:

1. Njesisë për Informim,
2. Udhëheqësit të Njesisë,
3. Arkivit të komunës.



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës
Nr. 01/____
Datë; 14/04/2022

PRANUAR NË:
ACCEPTED ON: 15-04-2022
PRANJENË:
Nr.No.Bi. 01/579

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja a, b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 14.04. 2022 mori këtë;

AKTVENDIM

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 560.00 €.

I I. Mjetet lejohen në emër të mbulimit të shpenzimeve për ushqim dhe pije të shkaktuara nga drejtoria për kulturë, rini dhe sport, përkatësisht me rastin e shtruarjes së drekës për familjarët e familjeve të dëshmorëve.

I I I. Mjetet ndahen sipas kërkesës së parashtruar nga drejtoria për kulturë, rini dhe sport, ndërsa për ekzekutimin e këtij aktvendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Komunës
Ekrem Kastrati

Aktvendimi ju dorëzohet :

1. Drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet,
2. Drejtorisë për kulturë, rini dhe sport,
3. Arkivit të komunës.



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë; 14/04/2022

PRIVATISIM

NUMER: 15-04-2022

PRILLOJ:

NUMER: 01/578

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja a, b dhe d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me nenin 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal (Ligji nr.03/L-049), dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 14.02. 2022 mori këtë;

AKTVENDIM

I. Lejohen mjetet financiare në shumën prej 471.79 €.

I I. Mjetet lejohen në emër të sigurimit dhe regjistrimit i automjetit VW- Tuareg me tabela zyrtare 04Z-06-30. Mjetet ndahen sipas kërkesës së parashtruar nga drejtoria për administratë.

I I I. Për ekzekutimin e këtij aktvendimi do të kujdeset drejtoria për ekonomi, financa dhe buxhet dhe drejtoria për administratë.

I V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Komunës
Ekrem Kastrati



Aktvendimi j u dorëzohet :

1. Drejtorisë për ekonomi, financa dhe buxhet,
2. Drejtorisë për administratë,
3. Arkivit të komunës.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës
Nr. 01/____
Datë: 12/04/2022

PRANITJE: 15-04-2022
REKLAM: 01/576
Nr. Nr. B:

Mbështetur në nenin 4, 8, 13, 24 dhe neni 58 (shkronja a, b dhe f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) si dhe duke u bazuar në Strategjinë për Parandalimin dhe Luftimin e Ethes Hemorragjike (EHKK) të hartuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës, kërkesën e parashtruar nga drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, nr.01/517, dt.06.04.2022,

Kryetari i Komunës me datë 12 .04. 2022 mori këtë;

VENDIM

PËR FORMIMIN E SHTABIT PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E ETHES HEMORRAGJIKE NË
TERRITORIN E KOMUNËS SË MALISHEVËS

I. Formohet shtabi për parandalimin dhe luftimin e Ethes Hemorragjike, në territorin e komunës Malishevës, për vitin 2022.

I I. Shtabi i lartëcekur do të përbëhet nga personat me emrat e poshtëshenuar.

1. Hajdin Berisha- drejtorit i drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale- kryesues i shtabit,
2. Shqipron Shala, drejtor i drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim- anëtar i shtabit,
2. Dr. Afrim Krasniqi- Drejtor i QKMF-së, " Shpëtim Robaj " në Malishevë- anëtar i shtabit,
3. Murat Hoxha- drejtor i drejtorisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural- anëtar i shtabit,
4. Rexhep Mazreku- zyra e kryetarit- anëtar i shtabit,
5. Artan Paçarizi- zyrtar për informim - ZIP,

I I I. Anëtarët e shtabit të formuar sipas nenit dy (2) të këtij vendimi, do të jenë personat kompetentë të cilët do të merren me përgatitjen dhe marrjen e masave të nevojshme dhe ligjore, në parandalimin dhe luftimin e Etheve Hemorragjike- Krime Kongo, në territorin e Komunës së Malishevës.

I V. Ky vendim hyn në fuqi me datë, 12.04.2022, i njëjti do të vlejë deri në një vendim tjetër të këtij organi.

Me vendim njoftohen:

1. Drejtoritë përkatëse,
2. Arkivi i komunës

Kryetari i Komunës
Ekrem Kastrati





REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës
Nr. 01/____
Datë: 08/04/2022

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 15-04-2022
PRILJENO:
Nr.No.Br: 01/ 575

Mbështetur në nenin 13 neni 24 dhe neni 58 (shkronja a, b, c dhe f) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Udhëzimin Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna, (MAPL)nr.06/2018, neni 8 dhe 9, dhe në mbështetje të Statutit të Komunës së Malishevës,

Kryetari i Komunës me datë 08.04.2022 mori këtë;

V E N D I M

I. z.Artan Paçarizi, i sistemuar me punë dhe detyra të punës, Zyrtar për Informim Publik, i caktohet detyra e zyrtarit përgjegjës për koordinimin e konsultimit publik, në komunën së Malishevës.

I I. I cekuri duhet që të kryej të gjitha përgjegjësitë në pajtim me, dispozitat e përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr.06/2018, për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, përkatësisht neni 8 dhe 9.

I I I. Caktimi i detyrave sipas udhëzimit të cekur, do të konsiderohen detyra që janë konform vendit të punës, për të cilin shërbyesi civil, e ka akt-emërimin dhe përshekrimin e detyrave të punës.

IV.Ky vendim hyn në fuqi me datë 08.04.2022, i njëjti do të jetë në fuqi, deri sa ky organ vendos ndryshe në lidhje me këtë çështje.

Kryetari i Komunës
Ekrem Kastrati



Vendimi ju dorëzohet:

1. Njësisë për Informim,
2. Zyrtarit për informim,
3. Arkivit të komunës.



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS



Kryetari i Komunës

Nr. 01/____

Datë: 14/04/2022

PROCESI NR. 15-04-2022
ACCEPTED ON: 15/04/2022
PRILJENO: 01/574
NENI 31

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 (shkronja a, f dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) dhe në pajtim me Statutin e Komunës së Malishevës, dhe kërkesës së drejtorisë për urbanizëm, dt.08.04.2022,

Kryetari i Komunës me datë 07 .04. 2022 mori këtë;

VENDIM

I. Ndryshohet, menagjeri i kontratës në lidhje me projektin “ Ndërtimi i kanalizimit nëpër fshatrat e komunës së Malishevës, lot 3, fshatrat Gurbardh, Maxharrë, Marali, Pagarushë, Burim, Kërvasari, Janqist, Guriq, Dragobil, Shkozë dhe Astrazup” kontrata nr.52, dt.09.11.2021, prot.03/79, sipas prokurimit identifikues 62500.21.052.511, dhe projektit “ Asfaltimi i rrugëve nëpër fshatrat, Bellanicë, Guncat, Senik, Banjë dhe Temeqinë “ sipas kontratës nr.47, dt.02.11.2021, prot. nr.03/74, me prokurimi identifikues 62500.21.113.521.

-Menagjerja e kontratës së cekur më lartë zj. Valdete Morina, e sistemuar me punë dhe detyra të punës inxhinieri e ndërtimtarisë në kuadër të drejtorisë për urbanizëm, zëvendësohet me zyrtarin e të njëjtës drejtori z.Jakup Shurdhaj, për të dy kontratat.

-Arsyeja e zëvendësimit sipas shkresës së drejtorisë për urbanizëm bëhet, pasi që zj. Valdete Morina, është e angazhuar n procesin e hartave zonale në drejtorinë për urbanizëm, dhe e ka të pa mundur që të kryej edhe funksionet e cekura si më lartë.

I I. Ky zëvendësim është kërkuar nga drejtori i drejtorisë për urbanizëm, sipas kërkesës së datës, 03.03.2022, ndërsa zyrtari i ri duhet të mbikëqyrë të gjitha procedurat sipas kontratës, ligjit dhe kontratës së lartcekur.

I I I. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi ju dorëzohet:

1. Komisionit
2. Arkivit të komunës

Kryetari i Komunës
Ekrem Kastrati





REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS
Kryetari i Komunës



PRANUAR ME
ACCEPTED ON
PRIMLJENO:
N. No. B. 559/10



Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L -040 mbi vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 7 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-12 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 90/2010"), nenit 35 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 17/2011"), nenit 5 shkronja (d) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës dhe nenit 9 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësit e Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, Kryetari i Komunës së Bellanices në cilësinë e udhëheqësit më të lartë Administrativ pas shqyrtimit të raportit final të datës: 27.04.2022, të rekomanduar nga komisioni përzgjedhës i emëruar me vendim të Kuvendit të Komunës Nr.02/97 i datës 03.03.2022, merr këtë:

VENDIM

Për pranimin në marrëdhënie pune

1. **z. Xhevdet Zogaj** nga Bellanica, zgjidhet në vendin e punës **Drejtor** në SHFMU "Ismail Qemali" në Bellanicë, duke filluar punën nga data 29.04.2022
2. Marrëdhënia e punës themelohet për periudhën kohore me kontratë 4 (katër) vjeçare.
3. Të lartpërmendurit në pikën 1 të këtij vendimi i caktohet koeficienti 7.8 poenë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Arsim dhe Edukim dhe Zyra e Personelit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Arsyetim

Duke u bazuar në raportin final dhe në rekomandimin e bërë nga komisioni përzgjedhës gjatë intervistimit të kandidatëve, të cilët kanë konkurruar në konkursin e shpallur nga Drejtoria për Arsim dhe Edukim në Komunën e Malishevës me Nr.Prot.11/81 të datës 28.01.2021 për plotësimin e vendit të lirë të punës drejtor/eshë në SHFMU "Ismail Qemali" në Bellanicë dhe në bazë të pikëve të fituara nga komisioni intervistues si dhe pas zbatimit të plotë të procedurës së rekrutimit, në të cilën ka aplikuar z. Xhevdet Zogaj, u vendos që drejtor në SHFMU "Ismail Qemali" në Bellanicë të caktohet z. Xhevdet Zogaj.

Andaj, nga sa u tha më lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese pranë Komisionit për shqyrtimin e ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në Komunën e Malishevës, në afatin prej 30 ditësh nga dita e pranimin të tij.

Vendimi u dërgohet:

- z. Xhevdet Zogaj nga Bellanica
- Drejtorisë për Arsim dhe Edukim,
- Zyrës së Personelit dhe
- Arkivit.

Ekrem Kasirati
Kryetari i Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E MALISHEVËS



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS MALISHEVE
THE MUNICIPAL ASSEMBLY MALISHEVE

Kryetari i Komunës

Nr. 01/___

Datë; 27/04/2022

PRANUAR ME:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

Nr.No.Br.

28/04/2022

01/663.

Mbështetur në nenin 13, 24 dhe neni 58 (shkronja a, b, f dhe g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji nr.03/L-040) Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 22 par. 22.4, neni 27 të Rregullores nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme

Kryetari i Komunës me datë 27 .04. 2022 mori këtë;

VENDIM PËR FORMIMIN E KOMISIONIT

I. Formohet, komisioni për ecurinë e zbatimit të planit dinamik si dhe kontratës në tërësi, në lidhje me Kontratën nr.01/782, dt.25.05.2016, Kontratë për dhënien shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale, sipas vendimit të kuvendit të komunës së Malishevës, nr.02/137, dt.06.05.2016

I I. Komisioni i formuar sipas nenit 1 të këtij vendimi, do të jetë në këtë përbërje;

- 1. Kushtrim Krasniqi-Kryetar i komisionit,
- 2. Ali Rrahmanaj- anëtar,
- 3. Driton Krasniqi- anëtar.

I I I. Ky komision është i obliguar të shqyrtojë dokumentacionin sipas kontratës së cekur në nenin 1 të këtij vendimi, të përgatit raport me shkrim dhe të njëjtin të paraqet pran këtij organi.

I V. Ky vendim hyn në fuqi me datë, 27.04.2022.

Kryetari i Komunës
Ekrem Kastrati



Vendimi ju dorëzohet:

1. Komisionit,
2. Arkivit të komunës.